



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 22

Prishtinë, më 23 qershor 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Gani Geci, Bajram Kosumi, Kolë Berisha, Ramadan Gashi, Ibrahim Makolli, Armend Zemaj, Selville Halimi dhe Mufera Şinik.

Munguan: Bahri Hyseni – kryetar (ishte në udhëtim zyrtar), Adem Hajdaraj dhe Radmila Vujović

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni, Sulltane Gashi dhe Visar Krasniqi

Mbledhjen e kryesoi: Gani Geci - nënkryetar i Komisionit

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Shqyrtimi i Projektligjit për ripranim për bazë juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës,
3. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për ripranim për bazë juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës

Kryesuesi - I njoftoi anëtarët se për shkak të urgjencës sot do ta kemi në shqyrtim Projektligjin për ripranim për bazë juridike. Po ashtu i njoftoi anëtarët se i kemi edhe amendamentet e Komisionit Funkcional, mirëpo ato nuk kanë ardhur me kohë që t'i paraqiten Komisionit për shqyrtim. Kjo ka ndodhur për shkak të vonësës rreth procedimit. Kërkoj përkrahje me qëllim që ky ligj të shqyrtohet në seancën e radhës, sepse është futur në rend të ditës. Për procedim sa më të shpejtë i paraqiti për shqyrtim edhe amendamentet e Komisionit Funkcional.

Armend Zemaj - Tha se parimisht duhet ta përkrahim, sepse e kemi dhënë njëherë mendimin për bazë kushtetuese dhe të njëjtin mund ta bëjmë edhe sot.

Ibrahim Makolli - Diskutoi rreth amendamentit 7 të Komisionit Funkcional. Shtoi se i mituri nuk mund ta kalojë kufirin pa shoqërues ose pa dokument nga gjykata, sepse kjo bie ndesh me ligjet e tjera, si dhe është në kundërshtim me konventën për ripranim. Dha arsyetime që të mos përkrahet amendamenti 7.

Bajram Kosumi - Tha se për shkak të urgjencës do të ishte mirë të kërkohet sqarim në seancë plenare, sepse nëse amendamenti i kthehet për shqyrtim Komisionit Funkcional, do të vonohet procedimi i tij me kohë.

Kryesuesi – Për të mos u zvarritur procedurat propozoi t'i kthehet Komisionit Funkcional shqyrtimi i amendamentit në fjalë dhe Ibrahim Makolli ta marrë për detyrë që në seancë plenare të kërkojë sqarim rreth këtij amendamenti.

Komisioni e përkrahu propozimin e kryesuesit që Ibrahim Makolli, në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjqësi, ta marrë për detyrë që në seancë plenare të kërkojë sqarim rreth këtij amendamenti.

3. Të ndryshme

Ibrahim Makolli - E ngriti çështjen për nenin 57 të Rregullores së punës të Kuvendit, në të cilin Komisioni për të Drejtat e Njeriut është paraparë si komision i përhershëm, ndërsa në nenin 69 nuk radhitet si komision i përhershëm dhe si duket ka mospërputhje. Pyeti a do të mund të propozojmë amendament apo të kërkojmë nga Komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore ta ndryshojë atë?

Mbledhja përfundoi në orën 14:15

Përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni